



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

TESTI I MATURËS

LËNDËT E PËRGJITHSHME


Emri dhe mbiemri i nxënësit _____

Shkolla _____

GJUHË AMTARE

GJUHË ANGLEZE

MATEMATIKË




Qershor 2015

Udhëzime:

Koha: Keni 200 minuta që t'u përgjigjeni 120 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

“Rrëfimet e mia janë reflektim i tregimeve të pleqve dhe jo reflektim i ndonjë letërsie të shkruar. Në fund të disa tregimeve kam vënë edhe emrin e atij që ma ka treguar. Përse? Për mirënjohje. Njeriu, pra edhe shkrimtari, duhet të jetë i ndershëm ndaj atij që ka ndihmuar. Një gjë të tillë kisha bërë edhe në përrallat e vëllimit Xinxifilua (kisha vënë emrin e tregonjësit), por redaksia e gjeti të udhës të heqë nga një vijë të zezë, të shlyejë emrat. Dhe më vjen keq”.

Mitrush Kuteli

1. Çfarë argumenti vihet në dukje, kur autori flet në këtë fragment për mënyrën se si vepron gjatë të shkruarit të rrëfimeve të tij?
 - A. Social
 - B. Etik
 - C. Psikologjik
 - D. Gjuhësor
2. Për çfarë këmbëngul autori i këtij fragmenti?
 - A. Se kush e ka treguar rrëfimin e dëgjuar
 - B. Se kush e ka shkruar rrëfimin e lexuar
 - C. Se kush e ka dëgjuar rrëfimin e lexuar
 - D. Se kush e ka incizuar rrëfimin e dëgjuar
3. Për çfarë ndjen keqardhje autori, duke rikujtuar një rast nga përvoja jetësore e tij prej shkrimtari?
 - A. Për ngjashmërinë e rrëfimeve të tij me tregimet e dëgjuara
 - B. Për ngjashmërinë e rrëfimeve të tij me tregimet e autorëve të tjerë
 - C. Për mungesën e ndershmërisë së shkrimtarit ndaj atij që e ka ndihmuar
 - D. Për shlyerjen e emrave të tregimtarëve në një nga vëllimet e tij
4. Me cilën fjalë mund të zëvendësohet fjala “reflektim”, në fjalinë: “Rrëfimet e mia janë reflektim i tregimeve të pleqve...”?
 - A. kallëzim
 - B. kumtim
 - C. pasqyrim
 - D. shqetësim
5. Kuptimi i cilës nga fjalitë në vijim jep qartësisht të njëjtin kuptim siç e jep edhe fjalia: *Redaksia e gjeti të udhës të shlyejë emrat në përrallat e vëllimit “Xinxifilua”*?
 - A. *Redaksia e pa të arsyeshme që të mos i vinte emrat në përrallat e vëllimit “Xinxifilua”*
 - B. *Redaksia e dëshmoi se si emrat e tregonjësave nuk janë të rëndësishëm në përrallat e vëllimit “Xinxifilua”*
 - C. *Redaksia e gjeti mundësinë t’i zëvendësonte emrat me inicialet në përrallat e vëllimit “Xinxifilua”*
 - D. *Redaksia e gjeti mundësinë t’i zëvendësonte emrat me pseudonime në përrallat e vëllimit “Xinxifilua”*

6. Nga leximi i këtij fragmenti, mund të arrijmë në përfundim se formimi letrar i Mitrush Kutelit ishte i ndikuar nga një bazë e trashëgimisë letrare:
- të letërsisë romantike.
 - të krijimtarisë gojore
 - të letërsisë së frymës antike
 - të letërsisë së frymës orientale
7. Çfarë na bie ndërmend, kur përmendim romanet e autorëve, si: Franc Kafka e Marsel Prusti?
- Janë romane të shquara të epokave të ndryshme letrare
 - Janë romane të shkruara në vargje dhe të ndarë në strofa
 - Janë romane të shquara të letërsisë moderne
 - Janë romane me heronj ndjenjash atdhetare
8. Në fjalinë: *O trim Gjergj, zot e mbret, o atë i shenjtë dhe mbrojtësi ynë, qysh na le jetimë dhe të shkretë si dhentë pa bari*, shprehja “si dhentë pa bari”, është e njëjtë si të thuhet:
- si delet pa çoban
 - si delet pa bar
 - si delet pa ilaç
 - si delet pa ahur
9. Një numër i kufizuar fjalësh kanë formë fonetike të njëjtë dhe kuptimi i tyre dallohet vetëm nga theksi.
- Në cilën rrokje bie theksi në fjalën dyrrokëshe “**bari**” në fjalitë: “*Kudo shkela, u tha **bari***” dhe “*Një **bari** po ruante delet*”?
- Në fjalën e parë - theksi bie në rrokjen e fundit, në fjalën e dytë – theksi bie në rrokjen e parë.
 - Edhe në fjalën e parë edhe në fjalën e dytë, theksi bie në rrokjen e fundit.
 - Në fjalën e parë - theksi bie në rrokjen e parë, në fjalën e dytë - theksi bie në rrokjen e fundit.
 - Edhe në fjalën e parë edhe në fjalën e dytë, theksi bie në rrokjen e parë.
10. Mbiemri është në shkallën krahasore, sa herë që cilësia e sendit të dhënë krahasohet për nga shkalla e saj me vetveten a me një cilësi tjetër. Në cilën nga shkallët është mbiemri në fjalinë: *Gjini ishte më i gjati e më i bukuri.*?
- Shkallën krahasore të barazisë
 - Shkallën krahasore të ultësisë
 - Në shkallën krahasore të sipërisë relative
 - Në shkallën krahasore të sipërisë absolute
11. Cila nga këto kategori i përket vetëm foljes, e të cilën nuk e ka asnjë pjesë tjetër e ligjëratës?
- katëgorinë e mënyrës
 - katëgorinë e numrit
 - katëgorinë e vetës
 - katëgorinë e shquarsisë
12. Në cilën nga periudhat në vijim, veprimi i shprehur nga fjalia e dytë është në kundërshtim me atë që duhej të ndodhte si pasojë logjike e veprimit të shprehur në fjalinë e parë?
- Fushë dhe fushë dhe fushë prapë
 - As ti nuk i bie mandolinës, as unë kitarës
 - Peshku është në det, tigani në zjarr
 - Qan puna për të zotin dhe i zoti qan për punë

- 13.** Cila nga shprehjet në vijim ka funksion tërësisht poetizues?
- dielli mëngjesor
 - dielli në mëngjes
 - dielli i mëngjesit
 - dielli gjatë mëngjesit
- 14.** Çfarë na kujton kjo fjali: “Un te pagezonj p’r emeni (t’) Atit e t’Birit e t’Shpertit Shenjt”?
- fjalja e parë e shkruar nga Gjon Buzuku
 - fjalja e parë e shqipes së shkruar
 - fjalja e parë me të cilën e uron babai - të birin
 - fjalja e parë me të cilën frymëzohet poeti
- 15.** Çfarë kuptimi shpreh fjalja: “Un te pagezonj p’r emni (t’) Atit e t’Birit e t’Shpertit Shenjt”?
- Është një mënyrë dramatike për të shprehur gëzimin
 - Është një mënyrë e veçantë për të uruar njerëzit
 - Është një mënyrë normative për të shprehur besimin në një fe
 - Është një mënyrë frymëzuese për të ecur mbarë punët e familjes
- 16.** Lirika, Epika, Dramatika - secila nga këto paraqet tipare të një gjinie letrare. Cila fjalë i përgjigjet kuptimit të gjinisë letrare përkatëse?
- Lirikë = ndjenja, Epikë = ngjarja, Dramatikë = aksioni
 - Lirikë = mendimi, Epikë = emocioni, Dramatikë = ndodhia
 - Lirikë = veprimi, Epikë = përsiatja, Dramatikë = historia
 - Lirikë = kujtimi, Epikës = dhembja, Dramatikë = malli
- 17.** Për çfarë dallimi bëhet fjalë, me rastin e dallimit midis *fabulës* dhe *syzheut* të një vepre letrare epike?
- Për dallimin midis “*kur kanë ndodhur ngjarjet*” dhe “*ku kanë ndodhur ngjarjet*”
 - Për dallimin midis “*çfarë ngjarjesh kanë ndodhur*” dhe “*mënyrës se si janë zhvilluar ngjarjet*”
 - Për dallimin midis “*kush ka marrë pjesë në ngjarje*” dhe “*çfarë kanë bërë ata në këtë ngjarje*”
 - Për dallimin midis “*sa veta kanë marrë pjesë në ngjarje*” dhe “*pse kanë marrë pjesë*”
- 18.** Cili lloj letrar ishte mbizotërues në periudhën e romantizmin shqiptar?
- novela
 - balada
 - tregimi
 - poema
- 19.** Cila vepër vlerësohet si i vetmi epos kombëtar i letërsisë shqipe?
- Bagëti e Bujqësi
 - Lahuta e Malcís
 - Këngët e Milosaos
 - Tat Tanushi

20.Në tregimin “**E madhe është gjëma e mëkatit**” të Mitrush Kutelit, jepet një histori e dashurisë ndërmjet një mashkulli e një femre. Cilët janë personazhet e kësaj historie?

- A. Marku e Diloca
- B. Lili e Lilusha
- C. Tanushi e Kalia
- D. Delia e Dila

21.Cili nga heronjtë i përket epikës heroike historike?

- A. Halil Garria
- B. Gjergj Elez Alia
- C. Paji Harambash
- D. Ali Pashë Tepelena

22.Cilat nga figurat letrare janë të kundërta për nga mënyra se si fjalët dhe shprehjet marrin kuptim nëpërmjet tyre?

- A. Litota e Hiperbola
- B. Metafora e Metonimia
- C. Ironia e Sarkazmi
- D. Simboli e Personifikimi

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Heshtëm për një çast. Nga dritarja frynte një erë e ngrohtë. Perdja e hollë lëkundej dhe herë pas here më binte në fytyrë.

- Ëndrra e shokut Zylo është të emërohet ambasador në ndonjë vend të Evropës, - tha Bakiri.

- E kam dëgjuar, - thashë unë.

Bakiri qeshi.

- Na tha një ditë se i ishin lutur ta emëronin ambasador në një shtet të huaj, por e kishte refuzuar, sepse nuk i pëlqente jeta monotone, pa njerëz të njohur, pa vende të njohura... "jashtë shtetit është mërzi për njerëzit që janë mësuar mes një shoqërie të madhe", - na tha.

Edhe mua m'u qesh. Bakiri e imitonte zërin e tij me përpikëri të madhe. Ai u jepte fjalëve intonacionet e shokut Zylo, ai bënte të njëjtat gjeste dhe të njëjtat lëvizje. Ndofta prandaj shoku Zylo ishte ftohur nga Bakiri. Nuk ka gjë më të tmerrshme se ta vësh njeriun në pozita qesharake. E qeshura e çarmatos njeriun. Aristofani me të qeshurat i çarmatosi perënditë. Bakiri kishte një zakon që kur thoshte ndonjë fjalë me humor, qeshte me zë të lartë dhe i binte gjunjëve me pëllëmbë, pastaj të cëmblihte në krah për të ta tërhequr vëmendjen.

(Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo)

23.Në dialogët e këtij rrëfimi, mënyra e komunikimit midis personazheve përvijon karakterin e tyre:

- A. tragjik
- B. komik
- C. fetar
- D. miqësor

- 24.** Kur Bakiri tregon për ëndrrën e shokut Zylo për t’u emëruar ambasador, ai ironizon synimin e tij. Cila situatë zbulon gjestin ironizues të Bakirit ndaj Zylos?
- Heshtja e Bakirit për të zbuluar gjithë synimet e shokut Zylo.
 - Grindjeve midis Bakirit dhe shokut Zylo.
 - Mënyra se si Bakiri imitonte sjelljet e shoku Zylo.
 - Shprehja e Bakirit që, kur fliste, t’u binte gjunjëve me pëllëmbë.
- 25.** Rrëfyesi në këtë fragment rrëfen nga pozita e:
- Vetës së parë njëjës
 - Vetës së tretë njëjës
 - Vetës së parë shumës
 - Vetës së tretë shumës
- 26.** Rrëfyesi është person që, në këtë fragment, me gjestin dhe fjalët e tij dëshmon se:
- Zylon e kishte mik
 - ndaj Zylos nuk kishte qëndrim të vetin
 - Zylon e kishte armik
 - për Zylon ndjente keqardhje
- 27.** Në pjesën: “Nuk ka gjë më të tmerrshme se ta vësh njeriun në pozita qesharake. E qeshura e çarmatos njeriun.”, shprehja “*E qeshura e çarmatos njeriun*”, do të thotë, që:
- e bën edhe njeriun e pikëlluar të qesh
 - e bën qesharak njeriun që qesh
 - i zbulon fshehtësitë e atij që qesh
 - i heq mundësinë tjetrit që të mbrohet
- 28.** Në fjalinë “E qeshura e çarmatos njeriun”, fjala “E qeshura” është:
- Emër
 - Përemër
 - Folje
 - Ndajfolje
- 29.** Në fjalinë “*qeshte me zë të lartë dhe i binte gjunjëve me pëllëmbë*”, trajta e shkurtër “i”, duhet të jetë “u”, sepse:
- “Qeshte” është folje në vetën e tretë njëjës
 - “Të lartë” është mbiemër i nyjshëm dhe cilësor
 - “Gjunjëve” është kundrinor i drejtë në shumës
 - “Pëllëmbë” është emër në numrin shumës
- 30.** Në fjalinë “E qeshura e çarmatos njeriun...”, fjala “çarmatos” është e ndërtuar me tipin e fjalëformimit me:
- prejardhje
 - paranyjëzim
 - kompozim
 - përngjitje

Lexo vargjet e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

“...në qoftë se Zeusi do më japë fitoren
e unë ty shpirtin do ta marr, betohem
ty përdhunisht s'do ta shëmtoj kufomën:
armët e ndjera do t'i zhvesh prej shtatit
dhe trupin tënd do t'ua kthej akejve.
Por që edhe ti kështu do bësh, m'jep fjalën".
Zymtë e shikoi Akil këmbëshpejti e i foli:
"Hektor i urryer, mos më fol për kushte,
pse besë nuk lidh luani me njeriun,
as ujku e qengji nuk bëjnë paqe mes tyre,
po i sajojnë kobe gjithnjë njeri - tjetrit.
Kështu ne të dy kurrë miq nuk do të bëhemi,
as njeri - tjetrit besë nuk do t'i japim,
pa rënë vdekur njëri prej të dyve
me gjak të vet të ngopë mizorin Ares.

- 31.** Ky fragment i takon njëres nga veprat më të mëdha të letërsisë botërore:
- A. Odisea
 - B. Iliada
 - C. Orestia
 - D. Persët
- 32.** Vargjet e kësaj poeme në metrikë njihen si heksametra daktilikë. Të përkthyer në shqip nga Noli, këto vargje këtu dalin:
- A. Gjashtërokësh
 - B. Tetërokësh
 - C. Dhjetërokësh
 - D. Dymbëdhjetërokësh
- 33.** Në këtë fragment zhvillohet një bisedë ndërmjet dy personazhesh. Cilët janë ata?
- A. Zeusi dhe Aresi
 - B. Akili dhe Aresi
 - C. Akili dhe Hektori
 - D. Hektori dhe Zeusi
- 34.** Të folurit e Akilit, që është personazhi i dytë që flet në këtë fragment, karakterizohet nga ndjenja e:
- A. dëshpërimit
 - B. urrejtjes
 - C. frikës
 - D. zilisë
- 35.** Në vargun “*me gjak të vet të ngopë mizorin Ares*”, emri i Aresit përmendet pasi në mitologjinë greke ai konsiderohej zot i:
- A. Luftës
 - B. Paqes
 - C. Tokës
 - D. Detit

- 36.**Rrëfimtari në këtë fragment flet në vargjet:
- A. Ja do të vras, ja shpirtin ma ke shkukur
 - B. Tani ballë teje s'më veton më syri
 - C. Zymtë e shikoi Akil këmbëshpejti e i foli
 - D. Hektor i urryer, mos më fol për kushte
- 37.**Drama ka qenë një nga llojet më të zhvilluara në letërsinë antike greke, por shkruhet edhe sot e kësaj dite. Personazhet në dramë emërtohen me termin:
- A. Vetje
 - B. Akte
 - C. Pamje
 - D. Didaskali
- 38.**Në fjalinë “*E, kur dy burrat ballë për ballë u sulën*”, “ballë për ballë”, ka kuptimin e ndajfoljes së:
- A. Vendit
 - B. Kohës
 - C. Mënyrës
 - D. Shkakut

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Tirana vjen në Prishtinë me “Vrasja e Maratit” të Kumbaros

Prishtinë, 2 prill

“Vrasja e Maratit”, shfaqja e vënë në skenën e Teatrit Kombëtar të Tiranës, nga regjisori Arben Kumbaro, projekti i tij më i madh, tashmë do të transferohet në Kosovë.

Regjisori Kumbaro dhe kasta e aktorëve të tij vijnë në Prishtinë, në datat 10 dhe 11 prill për të vënë në skenë shfaqjen Vrasja e Maratit, me ç’rast presin të kenë të njëjtin sukses si në Tiranë. Kolonia e 26 aktorëve, do të ngjitet në skenën e Teatrit Kombëtar të Kosovës për të inskenuar këtë pjesë brilante e cila, në interpretimin emocionues të artistëve, risjell një analizë të hollë filozofike të Revolucionit Francez mes diskutimeve që vijnë aktuale dhe në ditët tona.

- 39.**Sipas elementeve tekstore dhe pjesëve përbërëse, teksti i mësipërm gazetaresk i takon zhanrit të gazetarisë:
- A. Të radios
 - B. Televizive
 - C. Telegrafike
 - D. Të shtypur
- 40.**Pjesa e shkruar me shkronja *italike* në këtë lloj të gazetarisë njihet si:
- A. moto
 - B. prolog
 - C. epilog
 - D. titull

- 41.** Ky produkt gazetaresk i zhanrit informativ i takon llojit të njohur si:
- Kronikë
 - Lajm
 - Vox-pop
 - Reportazh
- 42.** Në fjalinë: “Regjisori Kumbaro dhe kasta e aktorëve të tij vijnë në Prishtinë, në datat 10 dhe 11 prill për të vënë në skenë shfaqjen *Vrasja e Maratit*, me ç’rast presin të kenë të njëjtin sukses si në *Tiranë*”, përgjigjet gazetareske janë renditur:
- Çka, kush, ku, kur, pse
 - Ku, kur, pse, kush, çka
 - Kush, çka, ku, kur, pse
 - Kur, pse, kush, çka, ku
- 43.** Titulli “*Tirana vjen në Prishtinë me “Vrasja e Maratit” të Kumbaros*” edhe pse gazetaresk përmban një figurë interesante stilistike:
- Metonimi
 - Krahasim
 - Anaforë
 - Epiforë

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Qeni i shtëpisë kur vdes, lë më pas pikëllim e dëshpërim, sepse vështirë të gjendet një rojtar aq i përkushtuar dhe i durueshëm.

Qeni është e vetmja roje e diktueshme që mbështet njeriun përpara çdo rreziku. Edhe ora e gjarprit sigurisht mbron njeriun pa e ditur fare ai rrezikun.

Por, duket, papërrjashtim, të gjithë gabojmë për qenin...

Sakrifica pa përfillur edhe shëndetin, e bën edhe qenin pjesë të dëlirë të shpirtit të shtëpisë dhe familjes.

Secila shtëpi dhe secila familje, secila shtëpi me oxhak, si thuhet, kishte qenin e vet.

Kanuni i Lekë Dukagjinit e mbron qenin e shtëpisë si pjesë e qenësishme dhe e njerëzishme e saj.

(Ibrahim Berisha, *Sociokulturë*)

- 44.** Gjykuar nga diskursi, leksiku dhe elemente të tjera, fragmenti është shkrim i zhanrit:
- mitologjik
 - kulturor
 - historiografik
 - publicistik
- 45.** Autori i këtij fragmenti përdor edhe referenca. Ato vërehen në fjalinë:
- Qeni është e vetmja roje e diktueshme që na mbështet përpara çdo rreziku.
 - Secila shtëpi dhe secila familje, secila shtëpi me oxhak, si thuhet, kishte qenin e vet.
 - Kanuni i Lekë Dukagjinit e mbron qenin e shtëpisë si pjesë e qenësishme dhe e njerëzishme e saj.
 - Sakrifica pa përfillur edhe shëndetin, e bën edhe këtë qen pjesë të dëlirë të shpirtit të shtëpisë dhe familjes.

- 46.** Cila nga fjalitë e këtij fragmenti, shmanget nga tema kryesore dhe kalon në një temë tjetër?
- A. Kanuni i Lekë Dukagjinit e mbron qenin e shtëpisë si pjesë e qenësishme dhe e njerëzishme e saj.
 - B. Qeni i shtëpisë kur vdes, lë më pas pikëllim e dëshpërim, sepse vështirë të gjendet një rojtar aq i përkushtuar.
 - C. Qeni është e vetmja roje e diktueshme që na mbështet përpara çdo rreziku.
 - D. Edhe ora e gjarprit sigurisht mbron njeriun pa e ditur fare ai rrezikun.

47. Në raport sinonimie me fjalën dëshpërim është fjala:

- A. Zhgënjim
- B. Molisje
- C. Sfilitje
- D. Hidhërim

Lexo vargjet e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Këjo sevdaja e insanit
Gjallë njerinë ç'e përvëlon,
Mahmudeja e Sulejmanit
Me gazep sokakut shkon.

Jelek kadife veshurë
Si mosnjeri në këtë dhë,
me buzë duke qeshurë,
ç'të ka hije moj Mahmude!

48. Për nga elementet stilistiko-letrare, kjo poezi i përket asaj që e njohim si letërsi e:

- A. Rilindësve
- B. Bejtexhinjve
- C. Vjetër
- D. Moderne

49. Përmbajtja e këtyre strofave shpreh frymën e tematikës jetësore, ndërsa që strofa e parë përkon me tematikën e jetës së:

- A. qejfit
- B. hallit
- C. lakmisë
- D. solidaritetit

50. Fjalët, sevdaja, insan, gazep, nuk janë fjalë burimore të shqipes. Këto huazime që ishin karakteristike për këtë lloj poezie quhen:

- A. barbarizma
- B. arkaizma
- C. orientalizma
- D. latinizma

51. Choose the correct alternative to complete the dialogue:


Linda: I hear you have finished school, so you are not high school student anymore.

Tom: Yes, it's true. We finished school last month on 8/5/2015.

Linda: Oh, right. It was Friday _____.

- A. eighth of May, two thousand fifteen
- B. eighth May, in two thousand and fifteen
- C. the eighth May, two thousand and fifteen
- D. the eighth of May, two thousand and fifteen

52. Look at the chart below and choose the correct answer:



- A. The percentage of teenagers who play games is higher than of those who play sports and do other activities.
- B. The percentage of teenagers who play sports is lower than of those who watch TV and use the Internet.
- C. The percentage of teenagers who watch TV is higher than of those who use the Internet and play games.
- D. The percentage of teenagers who use the Internet is higher than of those who watch TV and do sports.

53. Read the following sentences carefully:

1. Thank you, how much is that all?
2. Here you are. Thank you very much.
3. Yes, I'd like a chicken sandwich and a coke, please.
4. Can I help you?
5. Certainly, here is your sandwich and your coke.
6. That's £3.25.

The correct order of sentences to form a dialogue is:

- A. 4 3 5 1 6 2
- B. 3 5 4 1 6 2
- C. 4 5 2 6 3 1
- D. 3 2 5 4 2 6

54. ONLY ONE of the words can be used to complete the sentence. Which one?

You can defend your client in court only if you are a _____.

- A. defendant
- B. judge
- C. lawyer
- D. secretary

55. Choose the most suitable response that fits the situation:

Ben: Would you like to go to the cinema with me tonight?

Ana: Yes, why not? Can you pick me up at about 7 o'clock?

Ben: _____

- A. Yes, I'm thinking of it.
- B. Yes, I will wait for you at the cinema.
- C. Yes, Shall I wait for you at the cinema?
- D. Yes, I can. See you at seven then.

56. The sentence: '*She doesn't work on Sundays.*' is in the _____.

- A. present simple tense
- B. present perfect tense
- C. present perfect continuous tense
- D. present continuous tense

57. You are at the train station buying your ticket. Which one of the following expressions you cannot hear (or say) at the train station ticket office?

- A. Single or return?
- B. Could I have the bill please?
- C. Which platform is it?
- D. How long does it take?

58. Choose the correct alternative to complete the dialogue:

Ana: Why are you so angry?

Ben: Why did you take the keys? Didn't you know that _____?

- A. they're my
- B. they're of me
- C. they're me
- D. they're mine

59. Choose the sentence which is in the *present perfect tense*:

- A. They have just started the test.
- B. I had just finished the school.
- C. They will be here in a minute.
- D. I would have arrived much earlier.

60. Look at the following nouns. ONE DOES NOT exist. Which one?

- A. Explanation
- B. Confusion
- C. Recapturation
- D. Discussion

61. Choose the best way to join the following sentences:

The car dashed against a tree.

It was going at over 100 mph.

- A. The blue car was going 100 mph so it dashed against the tree.
- B. The blue car was going at over 100 mph but it dashed against the tree.
- C. The blue car was going at over 100 mph since it dashed against the tree.
- D. The blue car was going at over 100 mph because it dashed against the tree.

62. ONLY ONE of these questions is correct. Which one?

- A. Where you did buy that wonderful hat?
- B. Where did you buy that wonderful hat?
- C. Where that wonderful hat did you buy?
- D. Where did you that wonderful hat buy?

63. ONLY ONE of the following is a complete sentence. Which one?

- A. Her monthly wage being about.
- B. At one end, and at the other end a wall with a huge hole.
- C. She had made up her mind.
- D. To have been introduced to all of them by her.

64. Which word is different?

- A. annoying
- B. depressing
- C. appalling
- D. amazing

65. ONLY ONE of the words can be used to complete the TWO sentences given below.
Which one?

I replied to your _____ but you never responded. I was concerned.

Why don't you just _____ them and see where we stand?

- A. email
- B. letter
- C. facebook
- D. phone

66. Choose the most suitable alternative to complete the sentence:

If I don't do this test, I _____ my English.

- A. would improve
- B. could improve
- C. won't improve
- D. will improve

67. In the string of words: *parrot*, *pigeon*, *elephant*, *butterfly*, the word *elephant* is different because:

- A. it lives in the forests
- B. it can climb the trees
- C. It has ears and eyes
- D. it cannot fly

68.Read the following sentences carefully:

1. The first time I washed it, the color came out.
2. I took it back to the shop yesterday, but the shop assistant was really unhelpful.
3. Two weeks ago, I bought an expensive blue sweatshirt.
4. She refused to change it.
5. I went home feeling really upset.

The best combination for this paragraph is:

- A. 3 5 2 1 4
- B. 3 1 2 4 5
- C. 3 4 1 2 5
- D. 3 1 4 5 2

69.Choose the most suitable alternative that fits the situation:

'I am a good student,' Ana said.

Ana said that _____ .

- A. she is a good student
- B. she has been a good student
- C. she will be a good student
- D. she was a good student

Read the following text carefully and answer the questions 70 -74

Summer is almost here, which means it is time to sign your kids up for swim classes again at the Community Pool. Classes begin on Monday, June 1, and will continue throughout the summer. Fifteen swim classes are being offered. Each class lasts ten hours. A new class starts each week of the summer. Each class costs \$30. The pool is big enough for six students per class. Classes will increase in difficulty each week. The first week is for children up to six years old. The last week is for advanced swimmers who want to improve their race and endurance skills.

Students can sign up for as many classes as they like, but they must pass the skills level test. For example, students who sign up for Level 4 (Stroke Readiness) must show their certificate for completing Level 2 or must demonstrate the front *crawl* and backstroke. Children cannot sign up for a level they are not ready for. Children who have never attended Community Pool classes must show up April 29 or 30 for a swim skills evaluation. Instructors will rate the students and assign them to a particular skill level. Swim classes are fun for all. Children learn new skills and make new friends. Parents get to meet other parents in the community. Swimming, like bicycling, is a healthy and valuable skill that, once learned, is never forgotten.

"It's a joy to teach young children," said Ginger, the lead instructor for swimming programs.

"More than half of them are terrified when we put them into the water for the first time. Two months later, they're begging their parents to go to the pool every day."

70.The most suitable title for the text is _____.

- A. A swimming pool
- B. Swim classes begin
- C. Swimming is important
- D. The pool for everyone

71. According to the text, children who attend the community pool classes for the first time _____.

- A. have to have their swimming skills evaluated first
- B. may go to whichever class they like
- C. have to learn from the very beginning
- D. have to go to the community pool for a swim skills evaluation on the last two days

72. The word *crawl* in the second paragraph means _____.

- A. a swimming style without any moves
- B. a fast swimming stroke without stopping
- C. a swimming style involving movements forward
- D. a slow move on the head and knees along the ground and water

73. The benefit of swim classes, according to the text, is that children _____.

- A. can spend time in fresh air
- B. can enjoy being close to water
- C. can make a lot of money
- D. can learn new things and make new friends.

74. According to the text _____ decide which class students should go to.

- A. parents
- B. children themselves
- C. instructors
- D. both parents and instructors

Read the following text carefully and choose the most suitable alternative to complete the text (questions 75-79):

Today, we don't (75) _____ when we have an (76) _____ because there are anesthetics. These days, surgeons can (77) _____ many body parts and save lives. Vaccines are used to (78) _____ people getting some serious illnesses. The (79) _____ of new technology will help save even lives in the future.

75.

- A. hurt
- B. suffer
- C. pain
- D. ache

76.

- A. operation
- B. alarm
- C. attention
- D. experiment

77.

- A. change
- B. carry
- C. transplant
- D. manipulate

78.

- A. help
- B. specialize
- C. infect
- D. prevent

79.

- A. treatment
- B. development
- C. specialization
- D. connection

80. Choose the most suitable alternative to complete the dialogue:

Jill: Bye John, I must hurry. My train leaves in 20 minutes.

John: Bye Jill, don't forget to _____ when you get there.

- A. drop me a line
- B. drop me a letter
- C. drop me a call
- D. drop me a ring

81. ONLY ONE of these words is a verb. Which one?

- A. behind
- B. friendly
- C. defend
- D. collection

82. Choose the alternative that best completes the sentence:

I've decided to go on a diet. I'm absolutely _____ to lose weight.

- A. permitted
- B. determined
- C. reliable
- D. available

83. The correct pronunciation of the word *project* is:

- A. /'prɒdʒekt /
- B. /'prændʒekt /
- C. /'prædʒekt/
- D. /'prædʒeakt/

84. The correct spelling of the word /,kɒmpə'tɪʃn / is:

- A. competicion
- B. compitition
- C. campetition
- D. competition

85. One of the sentences DOES NOT fit the situation. Which one?

Ana: Excuse me, could you tell me if there is a bank in this street?

Bill: _____.

- A. No, I am sorry there isn't any.
- B. Yes, there is one just round the corner.
- C. No, I don't need to go to a bank.
- D. Yes, there is one. I can take you there if you want.

86. ONLY ONE of the sentences is correct. Which one?

- A. I am looking forward seeing to you and your family.
- B. I am looking forward to seeing you and your family.
- C. I forward am looking to seeing you and your family.
- D. I looking am forward to seeing you and your family.

87. In the string of words: *needful, gainful, awful, thoughtful, plentiful*, the word *awful* is different because _____.

- A. its meaning is negative
- B. its meaning is positive
- C. it ends in letter L
- D. it is an adjective

88. Complete the sentence with the most suitable word:

He is looking _____ a present to buy his mother.

- A. in
- B. on
- C. for
- D. to

89. Read the sign below. It means that the product

_____.

- A. can be used after December 2016
- B. can be used until December 2016
- C. it can't be used at all
- D. shouldn't be used during 2016



90. It is not a public holiday. It is celebrated in February. Government offices, stores, school and other organizations are open as usual. Public transit systems run on their regular schedule. Restaurants may be busier than usual as many people go out for an evening with their spouse or partner. It is called _____.

- A. Thanksgiving
- B. New Year's Eve
- C. Valentine's day
- D. Halloween


MATEMATIKË

91. Nëse vlenë $a^2 = 2025$ atëherë sa është vlera e shprehjes $(a+1)(a-1) - 2015$?

- A. 2010
- B. 10
- C. 9
- D. 0

92. Është dhënë katrori $ABCD$ me gjatësi të brinjës 4 cm . Pikat A_1, B_1, D_1 janë meset e brinjëve AB, BC, AD , përkatësisht. Sa është syprina e trekëndëshit $A_1B_1D_1$?

- A. 2 cm^2
- B. 4 cm^2
- C. 12 cm^2
- D. 16 cm^2



93. Nëse 250 gr lajthia kushtojnë $2,5\text{ €}$, sa kg lajthia mund të blihen për 24 € ?

- A. 2.4 kg
- B. 3.2 kg
- C. 4 kg
- D. 6 kg

94. Këndi 150° i shndërruar në radian, ka vlerën:

- A. $\frac{3\pi}{4}$
- B. $\frac{5\pi}{4}$
- C. $\frac{7\pi}{6}$
- D. $\frac{5\pi}{6}$

95. Në një aeroplan ka 108 ulëse për udhëtarë. Në çdo tre vende të mbushura njëri vend është i zbrazët. Nëse $\frac{1}{9}$ udhëtarëve e përbëjnë fëmijët, sa udhëtarë të rritur ka pasur në aeroplan ?


- A. 64
- B. 76
- C. 82
- D. 88

96. Lidhja ndërmjet njësisë në centimetra (y) dhe njësisë në incha (x), jepet me formulën $x = 2.54y$. Sa centimetra janë 30 incha ?

- A. 71.2 cm
- B. 75.6 cm
- C. 76.2 cm
- D. 76.8 cm


97. Suksesi i treguar në provimin e anglishtes nga nxënësit e një shkolle është dhënë në grafikun vijues. Cila është nota mesatare në këtë provim?

- A. 3.25
- B. 3.20
- C. 3.15
- D. 3.10



98. Një kuboid prej bakri, me përmasa $2\text{ cm} \times 4\text{ cm} \times 8\text{ cm}$ shkrihet dhe prej materialit të tij punohet një kub prej bakri. Sa do të jetë syprina e sipërfaqes të këtij kubi?

- A. 24 cm^2
- B. 36 cm^2
- C. 64 cm^2
- D. 96 cm^2



99. Të hënën, temperatura ishte 14°C . Të martën, temperatura ishte për 2 gradë më e lartë se të hënën. Të mërkurën, ishte për 3 gradë më e ultë se të martën. Të enjten, temperatura ishte për 2 gradë më e lartë se të mërkurën. Cila ditë kishte temperaturë më të ultë?

- A. Hënë
- B. Martë
- C. Mërkure
- D. Enjte

100. Janë dhënë pasqyrimet $f, g : R \rightarrow R$ me rregullat $f(x) = 2x - 1$ dhe $g(x) = 3x + 1$. Sa është $3 \cdot f(3) - 2 \cdot g(2) - 2$?

- A. -1
- B. 1
- C. -2
- D. 2

101. Sa është vlera e parametrin k në mënyrë që funksioni $y = \frac{k}{x} + 2$, $x \neq 0$ të kaloj nëpër pikën $M(-2, 0)$?

- A. -4
- B. 4
- C. -2
- D. 2

102. Formula $C = \frac{5 \cdot (F - 32)}{9}$, shpreh raportin mes temperaturës në shkallë Fahrenheit dhe shkallë Celsius. Sa është temperatura e shprehur në Fahrenheit nëse në Celsius ajo është 25 shkallë ?

- A. $77^{\circ}C$
- B. $75^{\circ}C$
- C. $69^{\circ}C$
- D. $65^{\circ}C$

103. Cili nga barazimet e dhëna është i saktë ?

- A. $\sqrt{a^2 + b^2} = a + b$
- B. $\sqrt{a^2 - b^2} = a - b$
- C. $\sqrt{a^2 \cdot b^2} = a \cdot b, \quad (a > 0, b > 0)$
- D. $\sqrt{\frac{a^4}{b^2}} = \left(\frac{a}{b}\right)^2$

104. Është dhënë ekuacioni $y = 9x^2 - 1$. Sa është vlera x për $y = 35$?

- A. $x = 2$
- B. $x = 9$
- C. $x < 2$
- D. $x > 9$

105. Sa është vlera e i^{2015} ?

- A. 1
- B. -1
- C. i
- D. $-i$


106. Monedhat metalike janë renditur sipas një rregulle që tregohet në figurë. Cila shprehje shkronjore i përgjigjet renditjes së monedhave?

- A. $n + 1$
- B. $3n - 2$
- C. $2n - 1$
- D. $4n - 3$




107. Sa është vëllimi i tendës që ka përmasa sipas të dhënave në figurë?

- A. $V = 10m^3$
- B. $V = 15m^3$
- C. $V = 20m^3$
- D. $V = 30m^3$




108. Cili nga pohimet është i saktë për grafikun e dhënë ?

- A. Funkzioni është linear.
- B. Ka kulm në pikën (2,3).
- C. Ka zero në pikat (0,0) dhe (6,0).
- D. Funkzioni ka këputje në pikën (0,0).



109. Është dhënë figura. Cila pjesë e syprinës së unazës rrethore është e ngjyrosur?

- A. $\frac{2}{3}$
- B. $\frac{1}{3}$
- C. $\frac{1}{4}$
- D. $\frac{3}{4}$



110. Cila është zgjidhja e ekuacionit $9 = \sqrt{x-4} + 5$?

- A. - 16
- B. 16
- C. - 20
- D. 20



111. Vetura kushton 20000 €. Për çdo vit i bie vlera 10%. Sa do të jetë vlera e kësaj veture pas dy vitesh?

- A. 16100 €
- B. 16200 €
- C. 16300 €
- D. 16400 €

112. Cilin kusht e plotëson zgjidhja e ekuacionit: $10 \cdot (x + 20) = 30 \cdot (x - 40)$?

- A. $x < 50$
- B. $x < 70$
- C. $50 < x < 100$
- D. $70 < x < 100$


113. Në figurë është paraqitur një model i formës 3-D. Cili rast i figurës e paraqitur në rrafsh paraqet pamjen e shikuar perballë?



- A. I.
- B. II.
- C. III.
- D. IV.

114. Një person arrin në udhëkryq **A** nga veriu. Ai nga pika **A** lëviz çdo herë duke zgjedhur një nga tre drejtimet. Cili është probabiliteti që ai të arrijë në pikën **B** pas 5 lëvizjeve?

- A. 0%
- B. 1% - 5%
- C. 5% - 10%
- D. 10% - 20%



115. Çfarë zgjidhjesh ka ekuacioni kuadratik $4x^2 + 1 = 4x$?


- A. Reale të ndryshme
- B. Të dyfishtë
- C. Komplekse të konjuguara
- D. Njëra zgjidhje është sa dyfishi i tjetrës

116. Cilat nga të dhënat vijuese paraqet mostër?

- A. Notat mesatare e secilit nxënës të një shkolle.
- B. Numri i të gjitha veturave të Republikës së Kosovës.
- C. Moshat anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
- D. Mosha e çdo të dhjetit shikues që hyn në Teatrin Kombëtar

117. Cila nga shprehjet vijuese paraqet pjesën e hijezuar të figurës?

- A. $(a + b)^2$
- B. $(a - b)^2$
- C. $a^2 + b^2$
- D. $a^2 - b^2$



118. Lartësia në të cilën gjendet topi t sekonda pas goditjes që bënë lojtari shprehet me formulën

$$h(t) = -2(t - 7)^2 + 98$$

Pas sa sekondash topi do të jetë në lartësinë $48m$?

- A. 12 sec
- B. 13 sec
- C. 14 sec
- D. 15 sec



119. I keni 30 euro, dhe i keni shkëmbyer për 45 dollar. Sa dollar (\$) do t'i shkëmbeni me 20 euro?

- A. 25\$
- B. 28\$
- C. 30\$
- D. 32\$

120. Numrat janë të renditur sipas një rregulle: 18, 36, ____, 72, ____, 108. Dy prej tyre mungojnë. Cilët numra mungojnë ?

- A. 38 dhe 74
- B. 42 dhe 78
- C. 45 dhe 81
- D. 54 dhe 90